



## Çfarë është Barometri Kosovar i Sigurisë?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i QKSS-së që synon të shërbejë si botim inovativ gjashtëmuor. Ky publikim synon matjen e trendeve të opinionit publik përsa i përket sigurisë dhe institucioneve të drejtësisë, si dhe sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova. BKS njihet për faktin që mban fokusin në çështjet e sigurisë dhe drejtësisë, dhe ç'është më e rëndësishmja është një prej iniciativave të planifikuara, të zbatuara dhe të komunikuar nga një institut vendor në Kosovë. QKSS nuk ka kurrfarë kufizimesh politike për të komunikuar të gjeturat dhe mesazhet e dalura. Së fundmi, BKS është unik edhe për qasjen metodologjike që ka.


## Kë kemi në shënjestër?

QKSS vë në shënjestër një sere akterësh të interesuar për të përcjellë trendët e opinionit publik në Kosovë në lëminë e sigurisë dhe drejtësisë. BKS fokusohet në politikë-bërësit në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor; praninë e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe selitë e tyre qendrore; organizatat vendore dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile; akademitë dhe mediet.

## Cili është ndikimi që pritet të ketë?

Ndikimi i këtij botimi pritet të jetë i shumëfishtë në periudhën afatmesme dhe atë për një sërë arsyesh, përfshirë këtu faktin që (a) QKSS gëzon besueshmërinë e një instituti neutral, (b) QKSS në produktet e saj zbaton metodat përkatëse shkencore, (c) rëndësisë që ka pronësia vendore dhe (d) kapacitetet profesionale që posedon QKSS.

Mbështetur nga:



\*\*\*

“Barometri Kosovar i Sigurisë tanimë është një program i konsoliduar i QKSS. Botimet e para u pranuan gjerësisht nga publiku. Ne kemi për qëllim të ndihmojmë reformat institucionale dhe të avokojmë për qeverisje të mirë”

**Florian Qehaja, KCSS**  
Drejtor Ekzekutiv

### Ekipi i BKS:

**Mentor Vrajolli,**  
Koordinator i Programit

**Skender Perteshi,**  
Koordinator i Hulumtimit në Terren

**Fjolla Raifi,** Ndihmës  
Koordinator i Hulumtimit në Terren

**Sofije Kryeziu,**  
Mbikëqyrëse në Terren

**Abit Hoxha,** Sigurimi i Cilësisë

**Donika Emini,**  
Interpretim i të Dhënave

## Metodologjia

Edicioni i tretë i BKS ofron përmbledhje të perceptimeve publike për institucionet e sigurisë dhe drejtësisë si dhe rreziqet dhe kërcënimet ndaj qytetarëve dhe stabilitetit ekonomik. Krahasuar me edicionet e mëparshme, edicioni i tretë përfshinë edhe një sërë pyetjesh shtesë që kanë të bëjnë me imigrimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

BKS realizohet përmes intervistave direkte që zhvillohen në Kosovë përmes një pyetëtori të përpiluar nga QKSS. Të gjitha pyetjet janë të mbyllura dhe shumica prej tyre janë në formën e shkallëve pesë-pikëshe të Likertit. Mostrat, pilotimi dhe intervistat janë zhvilluara nga ekipi i QKSS i përbërë nga më shumë se 30 hulumtues në terren. Mostra e nxjerrë kombëtare paraqet popullatën e Kosovës prej 18 vjeç e më shumë dhe përfshinë 1119 amvisëri. Sipas përkatësisë etnike, të intervistuarit janë: shqiptarë 83.7%, serbë 13.5%, boshnjakë 1.2%, turq 1.0%, dhe RAE 1.0%. Ky edicion ka dyfishuar mostrën për komunitetin serb (80 mostra më shumë) me qëllim që të merret një opinion më preciz lidhur me perceptimet e tyre për gjendjen aktuale të sigurisë në Kosovë.

Korniza e mostrës është bazuar në kodet e zonave telefonike që përfshijnë regjionin e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajit, Gjilanit, Pejës dhe Gjakovës. Faza e parë e kombinimit gjeografik është bazuar në Raportin nga Regjistrimi i Popullsisë [2012 në Kosovë](#), faza e dytë ka përfshirë mostrat e kombinuara sipas zonave komunale me një mostër të stratifikuar rurale/urbane sipas numrit të amvisërive.

Faza e fundit ka konsistuar në metodën e mostres rëndomtë që përdorë 'metodën e ditëlindjes'. Metoda e rëndomtë siguron që secili person, shtetas i Kosovës ka gjasa të jetë i përzgjedhur për intervistë. Si mostër reprezentative, rezultati i anketës mund të projektohet në popullatën e Kosovës si një imazh pasqyrë i trendeve në qëndrimet dhe perceptimet e të rinjve kosovarë në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3% me interval të konfidencës 95%.

Para fillimit të punës në terren, në shtator 2013 është zhvilluar një pilot intervistë. Ekipi hulumtues më pas deklaroi që kjo pilot-intervistë ishte e suksesshme, dhe se nuk ka pasur probleme të paraqitura me këto pyetje. Përvojat e mëhershme të zbatuara gjatë edicionit të parë dhe të dytë të BKS kanë shtuar besimin në mesin e stafit për të sofistikuar tutje mjetet metodologjike dhe zbatimin. Të gjitha intervistat kanë përfunduar gjatë muajit nëntor 2013. Përpunimi i të dhënave është bërë përmes softuerit SPSS.

Perceptimet e prezantuara në këtë raport janë përmbledhje e informatave të mbledhura nga të anketuarit, dhe ato dëshmojnë se çfarë perceptimi kanë qytetarët për këto institucione. Megjithatë ky raport nuk jep një vlerësim të cilësisë e punës së institucioneve që janë pjesë e këtij studimi. Roli i QKSS është kryekëput interpretimi i të dhënave që pasqyrojnë atë që qytetarët e Kosovës "e mendojnë dhe e thonë". Ekipi i QKSS nuk merr përgjegjësinë për rezultatet e të dhënave, veçanërisht nëse ato nxisin reagime në mesin e disa akterëve. Ekipi është i gatshëm dhe i interesuar që procesin dhe metodologjinë t'a bëjë transparente individëve të interesuar.

## Perceptimi publik për institucionet e sigurisë

Siç ishte rasti edhe me edicionin e parë dhe të dytë të BKS, të anketuarit janë pyetur se sa janë të kënaqur me punën e institucioneve të sigurisë. Ky edicion tregon që Forca e Sigurisë e Kosovës (66.8%), Zjarrfikësit (65%) dhe KFOR (62.4%) mbeten institucionet më të besuara në Kosovë. Krahasuar me edicionin e parë dhe të dytë të BKS, dallimi i vetëm është në përqindje, ngaqë; lista akoma kryesohet nga FSK, pasuar nga Zjarrfikësit dhe KFOR.

Grupi i dytë i institucioneve janë grupi për të cilin kënaqshmëria e publikut është mesatare. Ngjashëm si në edicionin e parë dhe të dytë të BKS, Policia e Kosovës mbetet në margjinat prej 43.4%. Perceptimi i qytetarëve ndaj Doganës është 36.3%. Ky edicion i BKS ka vlerësuar edhe perceptimin ndaj Ministrisë së Punëve të Jashtme (39.7%)

Trendët negative vazhdojnë të përcjellin punën e atyre që gëzojnë nivelin më të lartë të pakënaqshmërisë brenda grupit, më saktësisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme (33.8%), EULEX (31.4%) dhe Sistemit Gjyqësor të Kosovës (23.2%). Por, krahasuar me edicionin e dytë BKS ka pasur një ngritje të kënaqshmërisë me punën e MPB (26% në maj 2013) dhe EULEX (25% në maj 2013) duke treguar një trend pozitiv. Perceptimet e opinionit publik ndaj Agjencisë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) mbeten të paqëndrueshme dhe konfuze. Shumica e të anketuarve nuk kanë informata për strukturën e re të themeluar të Inteligjencës në Kosovë. Rreth 44.30% të të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen, apo nuk kishin informata të mjaftueshme për të vlerësuar punën e AKI. Ndërsa ata që ishin të gatshëm të ndajnë perceptimet e tyre lidhur me AKI ishin të kënaqur (18.7%), e që në fakt është një rënie e lehtë krahasuar me muajin maj 2013 (Edicioni i dytë i BKS). Përfaqësuesit e komunitetit pakicë në Kosovë kanë një perceptim ndryshe ndaj institucioneve të sigurisë, dhe kënaqshmëria më e lartë paraqitet të jetë ndaj Policisë së Kosovës, KFOR dhe EULEX.




Figura 1 Përceptimet e opinionit publik në Kosovë për institucionet e sigurisë




Figura 2 Perceptimet e opinionit publik në Kosovë për institucionet e sigurisë

### Besimi i publikut ndaj institucioneve shtetërore dhe joshtetërore

Kur janë pyetur për besimin e tyre në secilin institucion të sigurisë, opinionin publik i Kosovës vazhdon të ketë besim të madh tek FSK (68.50%), Zjarrfikësit (67.20%), Institucionet Fetare (61.40%) dhe KFOR (59.60%). Niveli i besimit ndaj këtyre tri institucioneve (FSK, Zjarrfikësit dhe KFOR-i) është i njëjtë me qëndrimin e publikut të shprehur në seksionet tjera që kishin të bënin me kënaqshmërinë. Por besimi në PK (49.10%) është më i lartë sesa kënaqshmëria, derisa kategoritë e reja siç janë organizatat e shoqërisë civile (OSHC) me (46%), dhe institucionet fetare me (64.40%) duken të jenë më të besuarat nga opinionin publik në Kosovë. Përgjithësisht, një numër i madh i institucioneve gëzojnë një shkallë pozitive prej 20%-40%.

Në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës duket të jetë institucioni më pak i besuar nga kosovarët, rreth 55.03% e opinionit publik në Kosovë nuk beson në Kuvendin e Kosovë, më pas vijon EULEX me vetëm 42.40%, dhe Ministria e Punëve të Brendshme 29.70%.




Figura 3 Besimi i opinionit publik në Kosovë ndaj akterëve shtetëror dhe joshtetëror




Figura 4 Besimi i opinionit publik në Kosovë ndaj strukturave të sigurisë

## Kontaktet dhe bashkëpunimi i opinionit publik me strukturat e sigurisë

BKS gjithashtu ka vlerësuar nivelin e ndërveprimit dhe komunikimit të qytetarëve me institucionet e veçanta të sigurisë. Në këtë mënyrë, anketa ka matur se në ç'mënyrë krijohet perceptimi publik; nga kontakti direkt apo përmes mënyrave të tjera. Ndërveprim më të shpeshtë qytetarët e kishim me policinë (42%) pasuar nga sistemi gjyqësor (31.49%) dhe doganat (29.90%). Ndërveprim pati edhe me KFOR-in (21.80%) dhe Zjarrfikësit (20.20%). Kosovarët më së paku ndërveprojnë me EULEX (92.60%) dhe FSK (89.50%).




Figura 5 Kontakti dhe bashkëpunimi me strukturat e sigurisë

## Perceptimet e opinionit publik lidhur me korrupsionin

Në përgjithësi, perceptimet e opinionit publik ndaj korrupsionit nuk dallojnë nga besueshmëria ndaj institucioneve. Të gjeturat nga BKS i fundit (edicioni i dytë) tregojnë që perceptimi ndaj korrupsionit në Kosovë sillet prej 60%-80%. Ndonëse ndryshimet e vogla pozitive nuk nënkuptojnë që gjendja në terren është përmirësuar. Korrupsioni shihet të jetë një prej sfidave më të mëdha politike dhe sociale, si dhe pengesa kryesore që po bllokton procesin e evropianizimit në Kosovë.

Siç shihet në grafikën më poshtë, një numër i madh i të anketuarve (50%-70%) besojnë që institucionet në vijim janë deri diku të korruptuara, të korruptuara ose shumë të korruptuara.

BKS i fundit ka treguar që rreth 80% e të anketuarve kanë raportuar që korrupsioni është shumë i përhapur në Qeveri në Kosovë. Ngjashëm me të gjeturat e kaluara, Qeveria e Kosovës, sistemi i shëndetësisë dhe gjyqësori janë listuar si institucionet më të korruptuara. Ka pasur një ndryshim të lehtë në përqindje, ndërsa të gjeturat e kaluara renditën sistemin e shëndetësisë dhe gjyqësorin si më të korruptuarat, duket sikur tani Qeveria po udhëheq. Në këtë edicion, Qeveria e Kosovës është e kryeson listën dhe shkalle a më lartë e të anketuarve me 70.50% që besojnë që niveli qendror është i korruptuar. Pas Qeverisë vjen sistemi shëndetësor (62.70%), sistemi gjyqësor (57.00%) dhe komunat (51.90%). Në anën tjetër perceptimet publike ndaj PK dhe Sistemit të Edukimit Publik janë shfaqur të jenë neutrale me një rezultat prej 30%-50%.

FSK është renditur të jetë institucioni më pak i korruptuar, i cili gjithashtu ka marrë një përqindje të lartë të përgjigjeve pa opinion, kjo për shkak të kohës së shkurtër që kur është themeluar institucioni si dhe mungesën e informatave mbi procesin e brendshëm të FSK-së.




Figura 6 Opinionii publik për institucionet më të korruptuara

## Opinionii publik lidhur me procesin për liberalizimin e vizave

Procesi i liberalizimit të vizave paraqet një ndër hapat më të rëndësishëm drejt integritimeve në BE; porse për shoqërinë dhe institucionet e Kosovës kjo mbetet të jetë sfidë e madhe. Të anketuarve u është kërkuar të rendisin sfidat kryesore të cilat aktualisht po pengojnë liberalizimin e vizave për Kosovën.

Siç është përmendur edhe në seksionin paraprak, respondentët besojnë që korrupsioni paraqet sfidën kryesore për Kosovën. Qeveria dhe institucionet kryesore të Kosovës janë renditur të jenë institucionet më të korruptuara në Kosovë dhe duket mjaft i arsyeshëm fakti që opinionii publik në Kosovë (58%) rendit korrupsionin si sfidën kryesore që pengon procesin e liberalizimit të vizave në Kosovë.

Çështja më e fundit që u ngrit nga mediat lidhur me azilkërkuesit; si dhe fluksi i madh i njerëzve të Kosovës që nisen drejt shteteve anëtare të BE-së ka shkaktuar problem të madh politik dhe social tek disa anëtarë të BE-së. Duke marrë parasysh faktorët e lartpërmendur, rreth 19% e të anketuarve besojnë që migrimi dhe azilkërkuesit aktualisht paraqesin një sfidë të madhe për integrimin në BE në përgjithësi dhe procesin e liberalizimit të vizave si një pjesë e vogël e rrugëtimit të gjatë për në BE.

Në anën tjetër një numër shumë i madh i të anketuarve beson që mungesa e sundimit të ligjit dhe sovranitetit paraqesin sfidë, pasuar më pas edhe nga krimi i organizuar dhe trafikimi i qenieve njerëzore (12%).






Figura 7 Opinioni Publik për çështjet kyçe që sfidojnë procesin e liberalizimit të vizave

### *Përceptimi i opinionit publik për gjendjen aktuale politike*

Që nga shkurti 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë, shteti i posalindur dhe institucionet e saj të sapothemeluara dhe të brishta u sfiduan vazhdimisht. Tranzicioni i stërzgjatur drejt demokracisë, spektri politik relativisht kompleks me akterë të ndryshëm të involvuar vendor dhe ndërkombëtar, shihen si problematike dhe jofunksionale nga shumica e kosovarëve.

Korrupsioni, mungesa e sundimit të ligjit, skandalet e njëpasnjëshme të Qeverisë së Kosovës përfshirë edhe sfidat lidhur me europianizimin kanë bërë që zërat e pesimizmit në Kosovë të shtohen. Kur të anketuarve iu kërkua që të vlerësojnë gjendjen aktuale politike në Kosovë, ata kryesisht kanë dhënë nota negative. 27% e kosovarëve besojnë që gjendja aktuale politike është shumë e keqe, ndërsa 26% e tyre mendojnë që është e keqe. Në anën tjetër 40% e konsiderojnë situata të jetë mesatar, ndërsa vetëm 7% prej tyre mendojnë që gjendja aktuale është e mirë. Asnjë nga të anketuarit nuk beson që gjendja meriton një vlerësimin më të mirë, apo shumë të mirë.





**Figura 8** Perceptimet e opinionit publik lidhur me gjendjen aktuale politike

### *Të ardhurat dhe gjendja e përgjithshme ekonomike*

Ngjashëm si me opinionin publik mbi gjendjen aktuale politike në Kosovë, gjendja ekonomike është vlerësuar të jetë kryesisht negative. Stagnimi ekonomik, mungesa e zhvillimit ekonomik dhe tregut të lirë, si dhe shkalla e lartë e korrupsionit kanë bërë që faktori ekonomik të shihet si sfida kryesore, por edhe si arsye e mundshme për një konflikt tjetër.

Shtimi i pesimizmit në mesin e kosovarëve shihet qartë në grafet më poshtë. Rreth 42% e të anketuarve besojnë që gjendja aktuale ekonomike është shumë e keqe, ndërsa 29% e tyre besojnë që kjo gjendje është e keqe. Në anën tjetër një përqindje e vogël e të anketuarve (25%) vlerësojnë që gjendja aktuale ekonomike është mesatare, dhe vetëm 4% e tyre mendojnë që gjendja është e mirë.



Figura 9 Opinioni publik mbi gjendjen e përgjithshme ekonomike dhe të ardhurat e tyre

## Gjendja ekonomike dhe të ardhurat gjatë këtij viti krahasuar me vitin e kaluar

Ngaqë faktori ekonomik është bërë sfida më e madhe për kosovarët, QKSS ka përgatitur një listë të pyetjeve për të adresuar këtë çështje. Kur iu është kërkuar të krahasojnë gjendjen aktuale ekonomike të të ardhurave të tyre në krahasim me vitin e kaluar, shumica e të anketuarve janë paraqitur të jenë mes dy opsioneve mesatare. Dy opsionet më dominuese tregonin që gjendja ekonomike (26.80%) dhe të ardhurat e tyre (32.50%) kanë mbetur të njëjta, ndërsa 46.70% dhe 46.50% besojnë që gjendja dhe të ardhurat e tyre personale janë përmirësuar pak.

Dy opsionet tjera më pak të kënaqshme si gjendja ekonomike (5.70%) dhe të ardhurat personale (4.40%) janë përkeqësuar shumë, ndërsa ata të cilët besojnë që gjendja ekonomike është përkeqësuar pak (12%) dhe kështu ka përkeqësuar edhe të ardhurat e tyre personale (7.70%). Grupi dominues i qytetarëve prej 35 – 40% besojnë që gjendja është përmirësuar paksa.

Siç shihet në dy grafet më poshtë, shumica e të anketuarve ishin më të prirë të kenë një këndvështrim më pesimist kur janë pyetur se çfarë do të ndodhë me gjendjen ekonomike karshi betejave të tyre me të ardhurat në vitin e ardhshëm. Ngjashëm, ekziston një ngritje e lehtë në numrin e atyre që besojnë se gjendja ekonomike (17.30%) dhe të ardhurat e tyre (8.90%) janë përkeqësuar tej mase. Trendi i njëjtë vazhdon edhe për opsionin i cili thotë se ka pak përkeqësim, ku proporcioni mes gjendjes ekonomike dhe të hyrave personale është 28.50% me 20.90%. Gjithashtu, një numër i madh beson që gjendja ka ngelur e njëjtë, duke vlerësuar gjendjen ekonomike me 35.30% dhe të ardhurat me 54.20%. Entuziazmi duket të jetë zbehur paksa, meqë vetëm 17.80% besojnë që gjendja ekonomike është përmirësuar, përderisa 15.10% pohojnë që të ardhurat e tyre janë përmirësuar. Vetëm 0.60% e të anketuarve besojnë që ka pasur një përmirësim të madh.




Figura 10 Gjendja e juaj ekonomike gjatë këtij viti krahasuar me vitin e ardhshëm




Figura 11 Gjendja e juaj ekonomike gjatë këtij viti krahasuar me vitin e kaluar

## A mendoni që papunësia dhe gjendja e rëndë ekonomike paraqesin rrezik të mundshëm për destabilizim?

Duke qenë që tërë bota është ndikuar nga krizat ekonomike të cilat shpesh kanë përfunduar me masa kursimesh, trazira dhe protesta masive, të anketuarit janë pyetur që të vlerësojnë nivelin e ndikimeve dhe rreziqeve të mundshme që do të mund të gjeneronin papunësia dhe mungesa e zhvillimit ekonomik.

Siç shihet në grafiet në vijim krahas mundësive dhe rreziqeve për destabilizim që vjen nga status quoja politike, Kosova rrezikohet edhe nga gjendja e rëndë ekonomike dhe mungesa e zhvillimit ekonomik. Të pyetur nëse gjendja aktuale ekonomike paraqet rrezik të mundshëm destabilizues, shumica e të anketuarve besojnë që kjo gjendje paraqet një rrezik të madh (45%) pasuar nga 35% e atyre që mendojnë se paraqet rrezik (38%), deri diku rrezik (11%), dhe rrezik të vogël (4%). Vetëm 2% e të anketuarve besojnë që gjendja ekonomike nuk paraqet fare rrezik.




Figura 12 A paraqesin gjendja e rëndë ekonomike dhe papunësia rrezik për destabilizim?

## A jeni të vetëdijshëm për të drejtën tuaj të privatësisë dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale?

Kur e tërë bota po adreson çështjen e të drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, QKSS ka ngritur këtë pyetje për të vlerësuar nëse opinioni publik është i vetëdijshëm për këto çështje, dhe nëse po sa janë kosovarët të vetëdijshëm për këto të drejta.

Derisa ende po zhvillohen debate të mëdha, opinionit publik në Kosovë sikur po i mungojnë informatat lidhur me të drejtën për privatësi dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale. Të pyetur nëse janë të informuar për këto dy të drejta themelore dhe të debatueshme, një numër i madh i qytetarëve janë shprehur se fare nuk janë të informuar me 55%, nuk janë të informuar me 15%, deri diku të informuar me 11%. Vetëm 19% e kosovarëve janë deklaruar të jenë të informuar për të drejtën për privatësi dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.




Figura 13 Opinioni publik për të drejtën në privatësi dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale

Dëshirojmë të shprehim falënderime të veçanta për kontribuuesit që kanë luajtur rol të rëndësishëm gjatë hulumtimeve në terren, mbikëqyrjes dhe monitorimit të procesit të të dhënave.

Ekipin e përbërnin: Adea Beqaj; Admir Shala; Albulena Hasani ; Andrra Pllana; Arber Fetahu; Besa Nimani; Dardana Perteshoni; Dhurata Prokshi; Donjeta Dedinca; Emine Makiqi; Endrit Binakaj; Fatmir Spahiu; Furtuna Shabani; Gent Azemi; Ideal Prokshi; Ilirjana Dakaj; Ilma Zaimi; Jetesa Shabanaj; Krenar Vasolli. Kushtrim Balaj; Marigona Dubovci; Mark Marku; Masa Stanisavljevic; Nektar Zogiani; Petrit Tahiri; Saranda Mellopolci; Shkelqim Berisha; Shpresa Kryeziu; Valmira Sokoli; Valton Marku; Vesel Kqiku

## Vërejtje

Perceptimet e prezantuara në këtë raport janë përmbledhje e informatave të mbledhura nga të anketuesit dhe ato vetëm dëshmojnë sesi qytetarët i perceptojnë institucionet. Ky nuk paraqet vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve që janë përfshirë në këtë studim. Ky studim do të shërbejë për të adresuar mangësitë e mundshme dhe gjithashtu paraqet një indikator të efektshmërisë së komunikimit të tyre me njerëzit. Qëndrimet e shprehura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe nuk paraqesin qëndrimet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë

Opinionet e shprehura në raport nuk paraqesin qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED).

Një kopje e këtij raporti dhe të informatave duhet adresuar në:

**Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)**

Rr. Sylejman Vokshi 13/3

10000 Prishtina, Kosovë

Email: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org)

Telefoni: +381 (0) 38 221 420

Faqja e internetit: [www.qkss.org](http://www.qkss.org)